

Kryepiskopi ynë Anastas e ka thënë shumë bukur; “në vend që të përshkruajmë errësirën le të ndezim një qiri”



Krishti u Ngjall!

“Në vend që të përshkruajmë errësirën le të ndezim një qiri” (Kryepiskopi Anastas)

Të dashur besimtarë,

Kohët e fundit është ngritur shqetësimi i vendosjes së mikroçipit në trupin e njeriut. Sipas këtyre zërave, gjithë situata e pandemisë Covid-19 është krijuar nga dora e njeriut për të arritur qëllimin, që me pretekstin e vaksinimit nga pandemia, të vendoset ky mikroçip. Nëse kjo është e vërtetë dhe do të zbatohet, atëherë shqetësimi i tyre mbi rrezikun e madh të cënimit të lirisë personale, sigurisht brenda saj edhe të lirisë fetare, është me të vërtetë një çështje serioze.

Por ajo që është më shqetësuese në këtë situatë është se disa besimtarë, jo vetëm

të krishterë, e lidhin vendosjen e mikroçipit me ngjarjet e fundit apokaliptike dhe Antikrishtin. Kujtojmë që Kisha e konsideron “Librin e Zbulesës”, një “Libër Profetik” dhe për këtë arsye nuk ka vendosur lexime të këtij libri gjatë Vitit Liturgjikal. Sigurisht nuk duam të bëjmë profetin, por e dimë se Zoti ka thënë që në kohët e fundit do të ketë një mundim shumë të madh (shih. Mt.kap.24), por gjithashtu dimë, siç kemi thënë edhe herë tjetër, që Zoti Krisht në mësimet e Tij na ka bërë të ditur se askush nuk e di kur është ajo kohë; “Tani sa për atë ditë dhe për atë orë, askush s’e di, as ëngjëjt e qiejve, por vetëm Ati im” (Mt.24:36).

Nuk duam të vëmë besimtarët në gjumin shpirtëror, përkundrazi duam t’ju kujtojmë se Kisha na mëson që nuk duhet të përgatisim veten tonë vetëm në momentet e fundit të jetës sonë, apo në kohën e ngjarjeve të fundit, por çdo ditë duhet të përgatisim veten tonë, pasi çdo ditë është një mundësi e takimit tonë me Zotin e Ngjallur!

Nga ana tjetër, përhapja e terrorit psikologjiko-shpirtëror, veçse e rëndon gjendjen e krijuar nga problemet e shumta të krijuara nga pandemia e virusit. Këta zëra vetëm sa frikësojnë, por nuk thonë kush është zgjidhja. Veç kësaj, a do të kenë fuqinë këta zëra të ndalojnë të mos ndodhin këto ngjarje? A kanë pushtetin dhe të drejtën të nxjerrin “Zotin gënjeshtar”?

Kjo pasi Zoti Krisht ka thënë se Ngjarjet e Fundit do të vijnë me siguri dhe Ai nuk na kërkon që të lutemi që të mos ndodhin këto ngjarje.

Sigurisht që do të ketë nga ata që duan një Krisht, që të jetë një mbret i fuqishëm tokësor, ashtu siç donin dikur judenjtë t’u sillte epokën e lavdishme të mbretit David. Sigurisht do të ketë nga ata që duan të jenë si apostulli Petro, që nuk duan të ndodhë plani i Perëndisë. Kujtojmë kur apostulli Petro tha; “ Zot, të shpëtoftë Perëndia; kjo nuk do të ndodhë kurrë” (Mt.16:22), kur kërkon që Krishti “të mos vritej dhe të ngjallej të tretën ditë”. Dhe cila ishte përgjigjja e Zotit Krisht; “Shporru prej meje, o Satan! Ti je një skandal për mua, sepse s’ke ndër mend punët e Perëndisë, por punët e njerëzve” (Mt.17:23).

Ne nuk mund të ndalojmë furtunën, por ne mund të marrim masa që kjo furtunë të jetë sa më pak e dëmshme. Kështu edhe Zoti na thotë që të lutemi “që të mund ta përballojmë këtë situatë”, na mëson që të lutemi “që të pakësohen ato ditë”, që të lutemi “që të mos të ndodhin në dimër”. Dhe për më tepër të forcojmë besën tonë tek Ai, “Spiranca e sigurtë”. Le të kujtojmë fjalët e shën Kozmait, “gjithçka mund të na i marrin, por vetëm Krishtin dhe shpirtin nuk mund të na i marrin, vetëm nëse do t’i japim vetë”. Dhe shenjtorët këtë shembull na kanë dhënë. Sa vuajtje, tortura dhe mundime kanë kaluar ata, por asgjë nuk i ka ndarë nga dashuria e Krishtit.

Të dashur besimtarë, në vend që të flasim vetëm për të Ligun dhe ligësitë e tij, le të kërkojmë të mbështetemi te kollona e Krishtit të Kryqëzuar dhe të Ngjallur. Kryepiskopi ynë Anastas e ka thënë shumë bukur; “ në vend që të përshkruajmë errësirën le të ndezim një qiri”. Le të mbajmë të ndezur dhe le të forcojmë flakën tonë te besimi në Dritën e Zotit të Ngjallur!

Me bekimet e Perëndisë,
Mitropoliti i Apollonisë dhe Fierit,
+Nikolla

— facebook.com/MitropoliaFier